



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 1000/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) dega në Prishtinë, paraqitur kundër Ilir Fazliut nga komuna e Prishtinës, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor të raundit të dytë gjatë zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosja (LVV) dega në Prishtinë.

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 02.12.2013, nga ana e subjekti politik LVV dega në Prishtinë, në të cilën theksohet se me datë 01 dhjetor 2013 rreth orës 11:00 në shkollën “ Gjergj Fishta” , në qendrën e votimit numër 1917e një votuese me emrin Mendohie Deda e cila ka qenë e shoqëruar nga nipi Altrin Hasani, kanë parë një person emrin e të cilit e kemi zbuluar më pas ai ishte Ilir Fazliu, i cili ka dhënë një votuesi 5 euro haptazi duke thënë edhe të tjerëve të pranishëm se këtu votohet për LDK-në.

Veprimi i Ilir Fazliut përbën shkelje të Kodit Penal të Kosovës 214, 215 par.1 dhe 4 me anë të cilit ndëshkohet kushdo që jep përfitim një personi me qëllim që të ndikojë atë person për të votuar një person të caktuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Nga dëshmit e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesit të LVV dega në Prishtinë. Mirpo pretendimet ankimore të kësaj natyre janë të pabazuara, pasi që dëshmitë e ofruara nuk janë të përgjithshme dhe janë të paqarta dhe të cilat nuk mund të vërtetohen.

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartëpërmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 1000/2013 më datën 04.12.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala**

***Këshillë Juridik:***

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 ( njëzetekatër ) orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.

